

HULUMTIM

PËR PJESËMARRJEN E OJQ-ve

NË HARTIMIN E

POLITIKAVE PUBLIKE

NË v. 2024

BOTUES:

Qendra për Zhvillimin e Organizatave Joqeveritare
(CRNVO)

rr. Sima Barovića 24, Podgoricë

Tel/fax: 020/219 120, 219 121, 219 122, 219 123

E-mail: crnvo@crnvo.me www.crnvo.me

Titulli i publikimit:

HULUMTIM PËR PJESËMARRJEN E OJQ-ve
NË HARTIMIN E POLITIKAVE PUBLIKE
NË v. 2024

PËR BOTUESIN:

Zorana Marković

AUTORËT:

Filip Vicković

Nazif Velik

Zdravko Janjušević

Marina Vuksanović

Milan Medenica

Kenan Kečević

Zorana Marković

BASHKËPUNTORËT NË HULUMTIM:

Milosh Marković

Aleksa Minić

Hazreta Cuca

PËRGATITJA dhe DIZAJNI

New Page D.O.O.

Podgoricë, korrik 2025.

Raporti u përgatit në kuadër të projektit “Rrjeti i qendrave burmiore të Malit të Zi”. Pikpamjet dhe përfundimet e paraqitura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal-Investues dhe bashkëpunimit me organizatat joqeveritare.

HYRJE

Pjesëmarrja e organizatave joqeveritare në proceset e hartimit të politikave publike përbën një nga treguesit kryesorë të zhvillimit të një shoqërie demokratike dhe të hapjes së institucioneve ndaj qytetarëve dhe sektorit të organizuar të shoqërisë civile. Si bartëse të njohurive specifike, përvojës nga terreni dhe kontaktit të drejtpërdrejtë me nevojat e komunitetit, organizatat joqeveritare kanë potencial të japin një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së politikave publike, zbatueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së tyre. Përfshirja efektive dhe domethënëse e shoqërisë civile në proceset e vendimmarrjes kontribuon në rritjen e transparencës së punës së institucioneve, forcimin e besimit të publikut dhe përgjegjshmërisë së bartësve të pushtetit, si dhe në zhvillimin e demokracisë pjesëmarrëse në tërësi.

Në Mal të Zi, kuadri normativ që rregullon pjesëmarrjen e organizatave joqeveritare në hartimin e politikave publike është vendosur si në nivel kombëtar, ashtu edhe në atë lokal. Rregulloret, ligjet dhe aktet nënligjore njohin mekanizma dhe forma të ndryshme bashkëpunimi ndërmjet organeve të administratës publike dhe organizatave joqeveritare, duke përfshirë pjesëmarrjen në grupe pune, konsultime publike, procese konsultative dhe në punën e kuvendeve lokale. Megjithatë, ekzistenca e zgjidhjeve normative nuk garanton në vetvete zbatimin e tyre të qëndrueshëm dhe thelbësor në praktikë. Shkalla reale e pjesëmarrjes varet nga niveli i informimit, hapja institucionale, vullneti politik, por edhe nga përvoja dhe perceptimi i vetë organizatave joqeveritare mbi kuptimin dhe efektet e angazhimit të tyre.

Në këtë kontekst, qëllimi i këtij hulumtimi është të ofrojë një pasqyrë mbi nivelin real, format dhe cilësinë e pjesëmarrjes së organizatave joqeveritare në proceset e hartimit të politikave publike në Mal të Zi gjatë vitit 2024, si dhe të identifikojë pengesat kryesore dhe faktorët motivues për përfshirjen e tyre më aktive. Hulumtimi është realizuar në bazë të një ankete me organizata joqeveritare që veprojnë në nivel lokal dhe kombëtar, dhe është zbatuar nga qendrat rajonale të burimeve (Qendra Demokratike e Bijello Poles, Horizonti i Ri dhe Zona Aktive) dhe zyrat lokale (OJQ Nada, Bonum dhe Natura), me mbështetjen e Qendrës Kombëtare të Burimeve, përkatësisht Qendrës për Zhvillimin e Organizatave Joqeveritare (CRNVO), në kuadër të programit Rrjeti i Qendrave Burimore të Malit të Zi, i mbështetur nga Ministria e Zhvillimit Rajonal-Investues dhe Bashkëpunimit me Organizatat Joqeveritare. Në këtë mënyrë është përfshirë një mostër e larmishme organizatash nga pjesë të ndryshme të vendit dhe fusha të ndryshme të veprimit, gjë që rrit rëndësinë dhe besueshmërinë e gjetjeve. Analiza e këtyre rezultateve synon të kontribuojë në një kuptim më të mirë të marrëdhënieve ndërmjet institucioneve dhe shoqërisë civile, si dhe të shërbejë si bazë për përmirësimin e praktikave dhe politikave ekzistuese në fushën e pjesëmarrjes së organizatave joqeveritare në proceset e vendimmarrjes.

Hulumtimi është realizuar në bazë të një ankete të shpërndarë nga qendrat rajonale dhe qendra kombëtare e burimeve tek organizatat joqeveritare. Përvojat e tyre i ndanë mbi njëqind organizata joqeveritare nga të gjitha rajonet e Malit të Zi, të cilat veprojnë në nivel kombëtar dhe/ose lokal.

KUADRI LIGJOR

Pjesëmarrja e organizatave joqeveritare në hartimin e politikave publike në nivel kombëtar rregullohet me Rregulloren për zgjedhjen e përfaqësuesve të organizatave joqeveritare në trupat punues të organeve të administratës shtetërore dhe zhvillimin e konsultimeve publike gjatë përgatitjes së ligjeve dhe strategjive, e miratuar në vitin 2018. Me këtë akt nënligjor janë përcaktuar mekanizmat bazë, procedurat dhe kushtet në bazë të të cilave organizatat joqeveritare mund të përfshihen në proceset e vendimmarrjes, me synim sigurimin e transparencës, gjithëpërfshirjes dhe përmirësimin e cilësisë së zgjidhjeve ligjore dhe strategjike. Rregullorja e njeh rolin e organizatave joqeveritare si partnerë të rëndësishëm të institucioneve në procesin e hartimit të politikave publike, veçanërisht në fushat ku këto organizata disponojnë njohuri specifike, përvojë dhe ekspertizë.



Në bazë të kësaj Rregulloreje, organizatat joqeveritare mund të marrin pjesë në hartimin e politikave publike në dy mënyra kryesore. Mënyra e parë nënkupton pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organizatave joqeveritare në punën e trupave punues, përkatësisht grupeve të punës dhe komisioneve të formuara nga organet e administratës shtetërore për përgatitjen e ligjeve, strategjive dhe politikave të tjera publike. Pjesëmarrja në këto trupa u mundëson organizatave joqeveritare të përfshihen drejtpërdrejt në procesin e hartimit të dokumenteve normative dhe strategjike, të japin propozime dhe sugjerime profesionale, si dhe të ndikojnë në përmbajtjen e zgjidhjeve që në fazën e hershme të formësimit të tyre.

Mënyra e dytë e pjesëmarrjes lidhet me përfshirjen e organizatave joqeveritare në procesin e konsultimeve publike gjatë përgatitjes së ligjeve dhe strategjive. Kjo formë e pjesëmarrjes mund të realizohet përmes konsultimeve paraprake në fazën fillestare të hartimit të akteve ligjore dhe dokumenteve strategjike, kur përcaktohen objektivat kryesore, drejtimet dhe zgjidhjet e mundshme, por edhe përmes pjesëmarrjes në konsultimet publike mbi projektligjet dhe projektstrategjitë. Konsultimet publike zhvillohen përmes mekanizmave të ndryshëm, duke përfshirë organizimin e tryezave të rrumbullakëta, tribunave publike dhe prezantimeve, si dhe dorëzimin e komenteve, propozimeve dhe sugjerimeve me shkrim mbi projekt-dokumentet, në formë të shkruar ose elektronike. Në këtë mënyrë, organizatave joqeveritare u jepet mundësia të paraqesin qëndrimet e tyre, të evidentojnë mangësitë e mundshme dhe të propozojnë përmirësime të zgjidhjeve të propozuara.

Në nivel lokal, pjesëmarrja e organizatave joqeveritare në hartimin e politikave publike rregullohet me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, përkatësisht me Kreun XIII – Marrëdhëniet ndërmjet organeve të vetëqeverisjes lokale dhe organizatave joqeveritare, konkretisht me nenin 174. Këto dispozita ligjore vendosin kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet organeve të vetëqeverisjes lokale dhe sektorit civil, me synim nxitjen e pjesëmarrjes aktive të organizatave joqeveritare në proceset e vendimmarrjes me rëndësi për komunitetin lokal.




Ligji parashikon disa forma të pjesëmarrjes së organizatave joqeveritare në hartimin e politikave publike lokale. Ndër to janë konsultimi i organizatave joqeveritare gjatë hartimit të programeve të zhvillimit të vetëqeverisjes lokale dhe projektakteve të përgjithshme që miratohen nga kuvendi i komunës; mundësimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesve të organizatave joqeveritare në grupet e punës për përgatitjen e akteve normative, si dhe në hartimin e projekteve dhe programeve lokale; organizimi i konsultimeve publike të përbashkëta, tryezave të rrumbullakëta, seminareve dhe formave të tjera të dialogut ndërmjet pushtetit lokal dhe sektorit civil.

Një mekanizëm i veçantë i pjesëmarrjes është instituti "karrigia e lirë", i cili u mundëson përfaqësuesve të organizatave joqeveritare të marrin pjesë dhe të kontribuojnë aktivisht në punimet e seancave të kuvendit komunal. Në këtë mënyrë forcohet më tej transparenca e punës së organeve lokale dhe komunikimi i drejtpërdrejtë me vendimmarrësit.

NIVELI I PJESËMARRJES

Pjesëmarrja e OJQ-ve në harimin e politikave publike në v. 2024



Megjithëse zgjidhjet ligjore ekzistuese në nivel kombëtar dhe lokal krijojnë formalisht mundësi për pjesëmarrjen e organizatave joqeveritare në proceset e hartimit të politikave publike, rezultatet e hulumtimit tregojnë se këta mekanizma përdoren në praktikë në një masë të kufizuar.

Gjatë vitit 2024, shumica e organizatave të anketuara, përkatësisht 59%, nuk morën pjesë në proceset e hartimit të politikave publike në asnjë nivel të pushtetit. Ky rezultat tregon një hendek të theksuar ndërmjet kuadrit normativ dhe zbatimit të tij në praktikë, si dhe nevojën për një analizë më të thellë të faktorëve që ndikojnë në nivelin e ulët të pjesëmarrjes së sektorit civil.


Është veçanërisht e rëndësishme të theksohet se mungesa e interesimit nuk është arsyeja kryesore e mospjesëmarrjes. Nga organizatat që nuk u përfshinë në këto procese gjatë vitit 2024, vetëm 15% deklaruan se arsyeja ishte mungesa e interesimit.

Arsyeja më e shpeshtë ishte pakënaqësia me rezultatet e pjesëmarrjes së mëparshme, të cilën e theksuan 36% e organizatave. Ky rezultat tregon se shumë organizata kanë perceptimin se angazhimi i tyre nuk ka pasur ndikimin e pritur në zgjidhjet përfundimtare, gjë që mund të çojë në demotivim dhe ulje të besimit në efikasitetin e mekanizmave pjesëmarrës.

Një faktor tjetër me rëndësi ishte mungesa e informimit për ekzistencën dhe mënyrën e përdorimit të mekanizmave të disponueshëm të pjesëmarrjes. Plot 22% e organizatave deklaruan se nuk ishin të informuara për mundësinë e përfshirjes në këto procese, gjë që tregon nevojën për rritjen e transparencës, komunikimit në kohë dhe qasjes në informacion nga institucionet kompetente.


Ky rezultat është veçanërisht domethënës, duke pasur parasysh se informimi përbën parakushtin themelor për pjesëmarrje aktive, ndërsa mungesa e tij kufizon drejtpërdrejt zbatimin efektiv të kuadrit ekzistues normativ.

Nëse jo, përse nuk morët pjesë në v. 2024?



Sa i përket organizatave që morën pjesë në hartimin e politikave publike gjatë vitit 2024, rezultatet tregojnë se pjesëmarrja e tyre ishte kryesisht e përqendruar në nivelin lokal.

Konkretisht, 65% e organizatave që ishin aktive në këto procese morën pjesë vetëm në hartimin e politikave publike lokale, gjë që mund të tregojë se mekanizmat e pjesëmarrjes janë më të qasshëm në nivel lokal, por edhe se organizatat janë më të interesuara për çështjet që lidhen drejtpërdrejt me komunitetet ku veprojnë. Vetëm 24% e organizatave morën pjesë ekskluzivisht në nivel kombëtar, ndërsa vetëm 11% u përfshinë njëkohësisht në proceset e hartimit të politikave publike në nivel lokal dhe kombëtar. Kjo tregon një lidhje të kufizuar vertikale dhe mungesë vazhdimësie në pjesëmarrjen e sektorit civil.




Analiza e shpeshtësisë së pjesëmarrjes tregon se angazhimi i shumicës së organizatave ishte sporadik dhe me intensitet të ulët.

Numri më i madh i organizatave mori pjesë nga një deri në pesë herë gjatë vitit, çka tregon karakter të rastësishëm të pjesëmarrjes.

Vetëm 6% e organizatave morën pjesë nga pesë deri në dhjetë herë gjatë vitit, ndërsa vetëm 2% patën një angazhim më intensiv, me më shumë se dhjetë përfshirje gjatë vitit.

Këto të dhëna konfirmojnë edhe një herë se, ndonëse ekzistojnë mekanizma formalë për pjesëmarrje, përdorimi i tyre mbetet i kufizuar dhe ende i pamjaftueshëm në praktikë.

Numri i pjesëmarrjeve gjatë vitit 2024



FORMAT E PJESËMARRJES

Sa i përket formave të pjesëmarrjes së organizatave joqeveritare në proceset e hartimit të politikave publike, rezultatet e hulumtimit tregojnë se shumica e organizatave që morën pjesë shfrytëzuan disa mekanizma të ndryshëm pjesëmarrjeje.

Ky rezultat tregon se organizatat e përfshira në proceset e vendimmarrjes përdorin kanale të ndryshme për të rritur dukshmërinë e qëndrimeve të tyre dhe ndikimin në përmbajtjen e politikave publike.

Në të njëjtën kohë, shumëllojshmëria e mekanizmave të përdorur dëshmon edhe fleksibilitetin e sektorit civil në përshtatjen me procedurat dhe kornizat e ndryshme institucionale.

Pjesëmarrja në konsultimet publike për projektaktet normative ose strategjitë përbën formën më të përhapur të pjesëmarrjes së organizatave joqeveritare në proceset e vendimmarrjes.

Gjatë vitit 2024, këtë mekanizëm e përdorën 70% e organizatave të anketuara që kishin marrë pjesë të paktën në një proces të hartimit të politikave publike, duke konfirmuar se konsultimet publike vazhdojnë të perceptohen si kanali më i qasshëm dhe më i përdorur i pjesëmarrjes.

Konsultimi paraprak i organizatave joqeveritare dhe i publikut të interesuar zhvillohet në fazën fillestare të përgatitjes së ligjeve ose strategjive në nivel kombëtar, përkatësisht gjatë hartimit të programeve të zhvillimit të vetëqeverisjes lokale dhe projektakteve të përgjithshme që miratohen nga kuvendi i komunës në nivel lokal.

Kjo formë e pjesëmarrjes u mundëson organizatave joqeveritare të përfshihen në proces që në fazën e hershme, kur ekziston hapësirë më e madhe për të ushtruar ndikim thelbësor në përcaktimin e problemeve, objektivave dhe zgjidhjeve të mundshme.


Megjithëse praktika e deritanishme tregon se konsultimi paraprak mund të ketë një ndikim të rëndësishëm pozitiv në cilësinë e politikave publike, rezultatet e hulumtimit tregojnë se ky mekanizëm vazhdon të jetë i pamjaftueshëm i përdorur.

Konkretisht, vetëm 23% e organizatave të anketuara deklaruan se gjatë vitit 2024 kanë shfrytëzuar këtë formë të pjesëmarrjes, gjë që mund të tregojë nevojën për zbatimin e saj më sistematik dhe për një nxitje më të fuqishme nga institucionet kompetente.



Organet e administratës shtetërore, si edhe organet e vetëqeverisjes lokale, zgjedhin përfaqësues të organizatave joqeveritare në grupet e punës dhe trupat e tjera punuese që formohen për përgatitjen e akteve normative, strategjive, projekteve dhe programeve. Pjesëmarrja në këto trupa u mundëson organizatave joqeveritare përfshirje të drejtpërdrejtë në procesin e hartimit të politikave publike, si dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me përfaqësuesit e institucioneve. Në këto trupa mund të marrin pjesë organizatat që plotësojnë kriteret e përcaktuara, të cilat kërkojnë që organizata, gjatë tre viteve të fundit, në fushën që trajtohet ose rregullohet nga trupi punues, të ketë realizuar një hulumtim, të ketë hartuar një dokument përkatës, të ketë organizuar një aktivitet ose të ketë zbatuar një projekt që synon përmirësimin e gjendjes në atë fushë. Këto dëshmi duhet të nënshkruhen nga personi i autorizuar për përfaqësimin e organizatës dhe të vërtetohen me vulën e organizatës joqeveritare. Të njëjtat rregulla zbatohen edhe për përzgjedhjen e përfaqësuesve të organizatave joqeveritare në trupat punues në nivel lokal, ku njësitë e vetëqeverisjes lokale kanë detyrimin ligjor të mundësojnë pjesëmarrjen e tyre në grupet e punës për përgatitjen e akteve normative ose hartimin e projekteve dhe programeve. Gjatë vitit 2024, 47% e organizatave të anketuara që ishin aktive në proceset e hartimit të politikave publike morën pjesë në punën e këtyre trupave.

Instituti "Karrigia e lirë" përbën një mekanizëm të veçantë pjesëmarrjeje që u mundëson përfaqësuesve të organizatave joqeveritare të marrin pjesë dhe të kontribuojnë aktivisht në punën e seancave të kuvendeve komunale. Në këtë mënyrë sigurohet që zëri i sektorit civil të dëgjohet drejtpërdrejt në parlamentet lokale, si dhe krijohet komunikim i drejtpërdrejtë ndërmjet organizatave joqeveritare dhe këshilltarëve komunalë. Për më tepër, ky institut kontribuon në rritjen e transparencës së punës së organeve të pushtetit lokal dhe në forcimin e kulturës demokratike në komunitetet lokale. Gjatë vitit 2024, mekanizmin "Karrigia e lirë" e përdorën 11% e organizatave të anketuara, çka tregon se ai ende përdoret në mënyrë të kufizuar, megjithëse ka potencial të konsiderueshëm.



Përveç formave formale të pjesëmarrjes në hartimin e politikave publike, një numër i konsiderueshëm organizatash deklaruan se kanë kontribuar edhe në mënyrë indirekte, duke përdorur mekanizma joformalë si: paraqitja e peticioneve; nismat qytetare; forma të ndryshme të avokimit publik. Edhe pse këto forma nuk janë gjithmonë të institucionalizuara, ato përfaqësojnë një mjet të rëndësishëm për artikullimin e interesave të qytetarëve dhe ushtrojnë ndikim pozitiv në zhvillimin e dialogut demokratik.

KËNAQËSIA ME PJESËMARRJEN


Nga përgjigjet në pyetjen "Në çfarë mase jeni të kënaqur me pjesëmarrjen tuaj gjatë vitit 2024?" mund të konstatohet se organizatat joqeveritare nuk kanë një qëndrim unik lidhur me kënaqësinë ndaj përfshirjes së tyre në proceset e hartimit të politikave publike. Organizatat e vlerësuan kënaqësinë në një shkallë nga 1 deri në 5, ku nota 1 nënkuptonte pakënaqësi të plotë, ndërsa nota 5 kënaqësi të plotë. Rezultatet tregojnë mendime të ndara dhe përvoja të ndryshme lidhur me cilësinë dhe efektet e pjesëmarrjes së tyre.

50% e organizatave deklaruan se ishin pjesërisht ose plotësisht të kënaqura me pjesëmarrjen e tyre gjatë vitit 2024. Ky rezultat tregon se një pjesë e organizatave e sheh angazhimin e tyre si të vlefshëm dhe konsideron se, në raste të caktuara, kontributet e tyre janë njohur dhe janë marrë parasysh nga vendimmarrësit. Nga ana tjetër, 30% e organizatave dhanë notën 3, që nënkupton një qëndrim neutral. Ky rezultat mund të tregojë se ndikimi i tyre ka qenë i kufizuar ose jo mjaftueshëm i dukshëm, si dhe se pjesëmarrja shpesh perceptohet më shumë si formale sesa thelbësore.

Ndërkohë, 20% e organizatave deklaruan se ishin pjesërisht ose plotësisht të pakënaqura me pjesëmarrjen e tyre. Ky rezultat tregon ekzistencën e përvojave negative dhe perceptimin se përpjekjet dhe burimet e investuara nuk janë reflektuar në ndryshime konkrete ose në pranimin e propozimeve të tyre.

Pakënaqësia mund të lidhet me mënyrën e organizimit të proceseve pjesëmarrëse, nivelin e respektimit të propozimeve të organizatave joqeveritare, por edhe me qasjen e përgjithshme të institucioneve ndaj sektorit civil.


Shkalla e kënaqësisë së pjesëmarrjes



Këto gjetje konfirmohen edhe nga përgjigjet lidhur me shkallën e pranimin të propozimeve të organizatave gjatë vitit 2024. Shumica dërmuese (63%) deklaruan se propozimet e tyre u pranuan vetëm pjesërisht. Vetëm 12% konsiderojnë se propozimet e tyre u pranuan plotësisht, ndërsa 25% deklaruan se asnjë prej propozimeve të tyre nuk u mor në konsideratë.

Këto të dhëna tregojnë se ndikimi real i organizatave joqeveritare në proceset e hartimit të politikave publike mbetet i kufizuar dhe mund të jetë një nga faktorët kryesorë që ndikon në perceptimin e efektivitetit të pjesëmarrjes.

A janë marrë para sysh propozimet tuaja?



Në kuadër të anketës, organizatat patën mundësi të japin përgjigje të hapura lidhur me atë se çfarë do t'i motivonte për një përfshirje më të madhe në proceset e vendimmarrjes dhe hartimit të politikave publike.

Analiza e përgjigjeve tregon se shumica e komenteve lidhen me nevojën për përmirësimin e organizimit të proceseve pjesëmarrëse.

Theks i veçantë iu kushtua:

- rritjes së transparencës;
- informimit të qartë dhe në kohë;
- qasjes më të lehtë në informacion mbi mundësitë dhe mënyrat e pjesëmarrjes.

Këto përgjigje tregojnë se organizatat i njohin mekanizmat formalë të pjesëmarrjes, por vlerësojnë se zbatimi i tyre në praktikë nuk është mjaftueshëm i dukshëm dhe i qasshëm.

Një grup tjetër i rëndësishëm përgjigjesh lidhet me kontekstin më të gjerë shoqëror dhe politik.

Shumë organizata theksuan se mungesa e vullnetit politik, sundimi i dobët i ligjit dhe gatishmëria e kufizuar e institucioneve për të marrë realisht në konsideratë kontributin e sektorit civil përbëjnë pengesa serioze për ushtrimin e ndikimit të tyre në politikat publike.

Në një mjedis të tillë, një pjesë e organizatave besojnë se, pavarësisht angazhimit aktiv, është e vështirë të arrihen ndryshime domethënëse në fushat ku ato veprojnë, gjë që ndikon negativisht në motivimin dhe gatishmërinë për t'u përfshirë në proceset e ardhshme.

PËRFUNDIM

Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se, megjithëse në Mal të Zi ekziston një kuadër normativ relativisht i zhvilluar që rregullon pjesëmarrjen e organizatave joqeveritare në proceset e hartimit të politikave publike, zbatimi praktik i këtyre mekanizmave mbetet i kufizuar.

Më shumë se gjysma e organizatave të anketuara nuk morën pjesë në asnjë proces të hartimit të politikave publike gjatë vitit 2024, ndërsa organizatat që morën pjesë e bënë këtë kryesisht në nivel lokal dhe me një intensitet relativisht të ulët.

Hulumtimi tregon se konsultimet publike vazhdojnë të jenë mekanizmi më i përdorur i pjesëmarrjes, ndërsa format e tjera, si konsultimet paraprake, pjesëmarrja në grupet e punës ose përdorimi i institutit "Karrigia e lirë", shfrytëzohen në një masë dukshëm më të vogël.

Rezultatet tregojnë gjithashtu se organizatat joqeveritare nuk janë plotësisht të kënaqura me rezultatet e pjesëmarrjes së tyre. Shumica e tyre konsiderojnë se propozimet e paraqitura pranohen vetëm pjesërisht, ndërsa një numër i konsiderueshëm organizatash besojnë se kontributi i tyre nuk reflektohet në dokumentet përfundimtare.

Si pengesat kryesore për pjesëmarrje më të madhe u identifikuan:

- mungesa e informimit në kohë;
- transparenca e pamjaftueshme e institucioneve;
- rezultatet e dobëta të pjesëmarrjes së mëparshme;
- mungesa e vullnetit politik;
- mungesa e besimit në ndikimin real të sektorit civil.

Nga ana tjetër, organizatat vlerësojnë se pjesëmarrja mund të përmirësohet përmes:

- informimit më të mirë dhe më të hershëm;
- zbatimit më konsekuent të mekanizmave ekzistues ligjorë;
- dialogut më të hapur ndërmjet institucioneve dhe organizatave joqeveritare;
- marrjes reale në konsideratë të komenteve dhe rekomandimeve të organizatave;
- forcimit të kapaciteteve të organizatave për pjesëmarrje në proceset e hartimit të politikave publike.

Në përgjithësi, rezultatet e hulumtimit tregojnë se ekziston potencial i konsiderueshëm për avancimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe shoqërisë civile. Megjithatë, për të arritur një pjesëmarrje më të madhe dhe më cilësore të organizatave joqeveritare, është e nevojshme që mekanizmat ekzistues të mos mbeten vetëm zgjidhje formale, por të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme dhe me përkushtim, duke siguruar që kontributi i sektorit civil të ketë ndikim real në proceset e hartimit të politikave publike.

Një pjesëmarrje e tillë do të kontribuojë jo vetëm në përmirësimin e cilësisë së politikave publike, por edhe në forcimin e transparencës, përgjegjshmërisë dhe besimit të qytetarëve ndaj institucioneve, duke ndërtuar një model më të qëndrueshëm dhe më gjithëpërfshirës të qeverisjes demokratike.

RRETH PROGRAMIT

Programi **“Rrjeti i Qendrave të Burimeve të Malit të Zi”** zbatohet me mbështetjen e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal-Investues dhe Bashkëpunimit me Organizatat Joqeveritare, me qëllim forcimin e kapaciteteve të organizatave joqeveritare dhe përmirësimin e mjedisit të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile në Mal të Zi.

Programi realizohet përmes Qendrës Kombëtare të Burimeve, të udhëhequr nga Qendra për Zhvillimin e Organizatave Joqeveritare (CRNVO), si dhe rrjetit të tre qendrave rajonale të burimeve dhe tre zyrave lokale.

Qendrat rajonale të burimeve janë:

- Qendra Demokratike e Bijello Poles – për rajonin verior;
- Horizonti i Ri (Ulqin) – për rajonin jugor;
- Zona Aktive (Nikshiq) – për rajonin qendror.

Zyrat lokale funksionojnë në:

- OJQ Bonum – Plav;
- OJQ Natura – Kotor;
- OJQ Nada – Herceg Novi.

Qëllimi i programit është të ofrojë mbështetje gjithëpërfshirëse për organizatat joqeveritare, grupet joformale të qytetarëve dhe institucionet publike, përmes:

- ofrimit të informacionit dhe këshillimit;
- asistencës juridike dhe teknike;
- ngritjes së kapaciteteve përmes trajnimeve dhe mentorimit;
- mbështetjes në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve;
- promovimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe organizatave joqeveritare në proceset e vendimmarrjes;
- zhvillimit të bashkëpunimit ndërmjet sektorit civil dhe institucioneve publike;
- nxitjes së transparencës, përgjegjshmërisë dhe qeverisjes së mirë.

Përmes rrjetit të qendrave të burimeve, organizatat joqeveritare në të gjitha rajonet e Malit të Zi kanë qasje në shërbime profesionale, mbështetje për zhvillimin organizativ dhe mundësi për përfshirje më aktive në proceset e hartimit të politikave publike dhe zhvillimit të komuniteteve lokale.

KE NJË PYETJE?

+ 382 20 219 860



crnvo@crnvo.me



<https://crnvo.me/>

